


Me renovimin e ndërtesave a mundet te sigurojmë konsum te energjisë si ndërtesat me energji t'ulët?

Sot, gjithnjë e më shumë flitet për shpenzimet te mëdha për ngrohjen e ndërtesave. Burimet më të përdorura të energjisë, lëndëve djegëse fosile, nga dita në ditë janë më të shtrenjta për shkak se kërkesa për to është në rritje, dhe rezervat janë ulur. Është interesante të theksohet se në vitin 2007 është parashikuar se çmimi i energjisë (naftë) për 25 vjet të rriten me 25%.Sot shohim se çmimi është rritur për 32%, për vetëm 5 vite. Shfrytëzimi i produkteve për prodhim te energjisë nga ana e derivateve fosile, lirojnë shume CO₂, i cili çdo ditë e më shume ndikon në ndërrimin e klimës në planetë. Sipas hulumtimeve të institucioneve të pa varura evropiane EURIMA, 41% prej harxhimit të përgjithshme të energjisë në EU harxhohet në sektorin e banimit. I njëjti burim tregon se dy e treta e harxhimit te energjisë përdoret për ngrohjen dhe ftohjen e ndërtesave. Dihet se pjesa më e madhe e nxehtësisë në ndërtesë humbet deri 25%) nëpërmes pullazi. Për këtë është me rëndësi që pullazi të jetë mirë i izoluar.

Membrana e plot e izolimit te shtëpisë me energji te ulet

Ndërtesat e zakonshme (pa izolim)

Ndërtesat me energji te ulet



Te renovimi i objektit relativisht me pak investim mund të zvogëlohet harxhimi i energjisë për 60%, aq sa janë humbjet për mes mureve dhe pullazit. Rëndësia e dytë e renovimit të ndërtesës është ndërrimi i dritareve dhe dyerve, i cili mund të sjellë deri 25% kursim energjie. Më së vështiri është të rinovohet ndërtesa, tek të cilat dëshirojmë të zvogëlojmë humbjen e energjisë nëpërmes themelit të dyshemesë, sepse rrallë kush vendos ta ndryshoi në tërësi konstruksionin e dyshemesë.

Me investime të vogla në ndërtesat e vogla mund te kursejmë te komponentët ndërtimore (izolimi i ngrohtë, dritare dhe dyer). Në qoftë se vendosni për ndërrimi ne sistemit për ngrohje, investimet janë më të mëdha, sepse harxhimi i ndërrimit të stufës është i barabartë ose më i madh se sa komponentët ndërtimore, kursimi i energjisë nuk rritet njëjtë si tek rasti i komponentëve ndërtimore.